



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilidheni/Prodato Received/Delivery	07-03-2023	3 viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBSTR	2460/2023		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.279/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.279/2023 të datës 31.01.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit/Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike '*kërkesë nga marrëdhënia e punës*', duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 07.03.2023, mori këtë:

### V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.279/2023 e datës 31.01.2023 e parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Lipjanit, me datën 31.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1117/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me shkrim të datës 25.01.2023 të organit të punësimit/Zyrës së Personelit të Komunës së Lipjanit lidhur me refuzimin e kërkesës së ankueses për kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive në emër të diferencës së koeficienti të pagës nga 7.5 në 8.5, për periudhën nga viti 2014 e tutje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 08.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Lipjanit. Ndërsa Këshilli, me datën 22.02.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1117/2023 të datës 31.01.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë me Nr.1-120/02-3969 të datës 25.01.2023 nga Komuna e Lipjanit; Kërkesën e ankueses me numër 1-120/02-3969 të datës 23.01.2023 e parashtruar nga ankuesja tek Komuna e Lipjanit; Vendimin Nr.1-120/04-1295 të datës 10.01.2023 i nxjerre nga Kryetari i Komunës së Lipjanit; Akt emërimit e ankueses me numër AE.Nr.1-120/04-1295 të datës 10.01.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 1616/2023 të datës 08.02.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Formularin mbi përshkrimin e detyrave të punës së ankueses.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit nga provat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesja është e punësuar në Komunën e Lipjanit në pozitën e punës *Udhëheqëse e Sektorit për Çështje Pronëso- Juridike*. E njëjta me datën 09.12.2022 kishte parashtruar ankesë për harmonizimin e koeficientit të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5), në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.1132/2022 të datës 29.12.2022 ka aprovuar ankesën e ankueses si të bazuar dhe ka obliguar organin e punësimit që ankueses t'ia harmonizoj koeficientin e pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës, nga 7.5 në (8.5), ku si rrjedhojë organi i punësimit, respektivisht Komuna e Lipjanit, me datën 10.01.2023, Kryetari i Komunës së Lipjanit ka nxjerrë Vendimin Nr.1-120/04-1295 sipas të cilit ankueses i është aprovuar kërkesa për ndryshim të koeficientit nga 7.5 në 8.5 dhe me datën 10.01.2023 i është lëshuar akt emërimit sipas koeficientit 8.5.

Ankuesja me datën 23.01.2023, ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Lipjanit për kompensimin retroaktiv të diferencës së koeficientit për periudhën nga viti 2014 deri me datën 01.01.2023. Udhëheqësi i Personelit përmes përgjigjes së datës 25.01.2023 ka refuzuar kërkesën e ankueses të datës 23.01.2023, me arsyetimin se koeficienti i pagës tetë pikë pesë (8.5) do të vlejë vetëm nga data e zbatimit të vendimit të Këshillit.

E pakënaqur me përgjigjen e datës 25.01.2023 të organit të punësimit, ankuesja me datën 31.01.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive nga data 20.11.2014 e deri më 31.12.2022.

Kolegji i Këshillit, shqyrtoj pretendimin ankimor të ankueses lidhur me kompensimin e diferencës së një koeficienti të pagës në mënyrë retroaktive, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankueses si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesja me datën 28.05.2014 ka nënshkruar aktin e emërimit për pozitën e punës *Shef Sektori për Çështje Pronëso- Juridike* me koeficient të pagës shtatë pikë pesë (7.5) dhe se e njëjta edhe përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datën 23.01.2023, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesja kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 14.02.2013), përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohej se: 130.1. *Ankimi*



administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.

Theksuar si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.279/2023, datë 07/03/2023.

Ardita Percuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së